

REPublika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Ref. Nr. 35871/2021
Data 05.10.2021
Date

Nënskrimi
Signature

PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINA

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

TEATRIT TË QYTETIT TË PODUJEVËS

Neni 1
Qëllimi i Memorandumi të Bashkëpunimit

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është mbështetja financiare për Teatrin e Qytetit të Podujevës gjatë vitit 2021, nga Fondi I ringjalljes ekonomike të Departamentit të Kulturës, kodi 805-subvencion, për realizimin e shfaqjeve teatrale.

Neni 2
AUTORITETET

Qëllimi i Memorandumi do të përmbushet nga:

2.1. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit: dhe

2.2. Teatri i Qytetit të Podujevës

(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

Neni 3
OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT(me tutje MKRS)

MKRS-ja merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit si në vijim:

3.1.1. Ofron mbështetje financiare në vlerë prej 25 (njëzet e pesë mijë) euro, , nga Fondi I ringjalljes ekonomike të Departamentit të Kulturës, kodi 805-subvencion, për realizimin e shfaqjeve teatrale gjatë vitit 2021.

3.1.2. Ministria për Kulturë Rini dhe Sport, cakton një person përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të këtij Memorandumi.

3.2. OBLIGIMET E TEATRIT TË QYTETIT TË PODUJEVËS

Teatri i Qytetit të Podujevës merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

3.2.1. Teatri I Qytetit të Podujevës merr përsipër të dorëzojë në MKRS projekt propozimet me specifikacionet buxhetore për realizimin e projekteve teatrale.

3.2.2. Teatri I Qytetit të Podujevës siguron që shpenzimin e buxhetit sin ë pikën 3.1.1. të këtij Memorandumi ta bëjë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe arsyeton mjetet e shpenzuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

3.2.3. Teatri I Qytetit të Podujevës pas përfundimit të realizimit të këtij Memorandumi paraqet në MKRS një raport përfundimtar të zbatimit të Memorandumi.

Neni 4
ZBATIMI

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Podujevës e përcjellin zbatimin e Memorandumi të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e Memorandumi.

Neni 5
MUNDESIA E NDERPRERJES SË MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT DHE
RRETHANAT E PAPANASHIKUARA

- 5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet dy palëve.
5.2. Nëse implementimi i këtij memorandum nuk mund të realizohet për shkak të ndodhjeve të fuqisë natyrore - Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 6
AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimit të Memorandumit të Bashkëpunimit është për vitin 2021.

Neni 7
AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amandament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

Neni 8
Zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

Neni 9
Kopjet dhe gjuha e memorandumit

Ky Memorandum është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

Neni 10
Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Ky memorandum i bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët dhe është i vlefshëm deri më 31 Dhjetor 2021.

Ibër Alaj

Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MKRS



Teatri i Qytetit të Podujevës

Nënshkruar më 04/10/2021
Prishtinë

